



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 09, datë 22.01.2021

**“PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, QYTETI ÇOROVODË”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 22.01.2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Komisioni i Shpronësimeve për Interes Publik, në Bashkinë Skrapar, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2, germa “b”, neni 54, germa e, Ligjit Nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik”, i ndryshuar, VKM- në Nr.89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, qyteti Çorovodë”
2. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompesohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë të llojit: “Tokë truall”, në shumën 2 030 000 (dy milionë e tridhjet mijë)leke.
3. Vlera financiare e shpronësimit për interes publik prej 2 030 000 (dy milionë e tridhjet mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar , zëri “shpronësime”, miratuar me VKB Nr.68, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2021 dhe të projekt-buxhetit afatmesëm 2021-2023 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”.

Nr	Emeri Pronarit	Nr.pasurise Sipas ASHK-Skrapar	Lloji i Pasurise	Zona kadastrale	Siperfaqja (m <sup>2</sup> )	Vlera (lek)	Dokumenti i pronesise
1	Selam Teki Koprëncka	55/61-1	Truall	1420	1025	1 040 375	Çertifikat pronesie
2	Hektor Teki Koprëncka	55/59-1	Truall	1420	675	685 125	Çertifikat pronesie
3	Mysel Virgjil Koprëncka	55/4-1	Truall	1420	300	304 500	Çertifikat pronesie
<b>SHUMA TOTALE</b>				<b>2000</b>	<b>2 030 000</b>		



4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Bashkia Skrapar
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**

**Edlira SHKËMBI**

